



VJETORI I LAUDATO SI': TA JETOJMË NJËMEND KARIZMËN TONË FRANÇESKANE

Në mbushjen e 5-vjetorit të botimit të Enciklikës *Laudato Si'*, mbi kujdesin për shtëpinë e përbashkët, ndërsa njerëzimi është duke kaluar një prej krizave më të mëdha shëndetësore, papa Françesku ka shpallur një vit të veçantë për përvjetorin e *Laudato Si'*. Argumentet e rrahura në enciklikë marrin rëndësi më të madhe në kontekstin aktual në të cilin krizat shoqërore dhe ekologjike janë rënduar dhe janë bërë të dukshme, mjafton të shohim pabarazinë e turpshme për aksesin në asistencën shëndetësore në shumë vende.

Kthimi ekologjik integral është një prej propozimeve të bëra nga Papa në letrën e tij. Meqenëse problemet nuk paraqiten në mënyrë të izoluar, por të ndërlidhura, një kthim integral duhet t'i përkasë, ndër të tjera, sferës politike, shoqërore, mjedisore dhe ekonomike. Në këtë mënyrë do të jetë e mundur të përballohet kriza e madhe socio-mjedisore që jemi duke jetuar.

Dikasteri për Zhvillimin Njerëzor Integral fton gjithë gjininë njerëzore të kremtojë nga 24 maji 2020 deri më 24 maj 2021 "një vit të veçantë për të përkujtuar përvjetorin e *Laudato Si'*". Gjatë këtij viti dhe dhjetëvjeçarit që vjen, le të përgatitemi të jetojmë së bashku një përvojë Kairos-i të vërtetë që do të kthehet në një kohë "Jubileu" për Tokën, për njerëzimin dhe për të gjitha krijesat e Hyjit.

Për këtë arsye, DDHI ofron një program që propozon një seri nismash në lidhje me *Laudato Si'*, një ftesë drejtuar institucioneve të ndryshme për të marrë pjesë dhe për t'u angazhuar në një plan afatgjatë (shtatë vjet) si ecje drejt qëndrueshmërisë së plotë në shpirtin e *Laudato Si'*-së.

Në të njëjtën mënyrë, në muajin qershor, Tryeza Ndërdikasteriale e Selisë së Shenjtë mbi ekologjinë integrale, ka paraqitur dokumentin "**Në ecje drejt kujdesit për shtëpinë e përbashkët – Pesë vite pas enciklikës *Laudato Si'***". Teksti synon të kërkojë një ndërhyrje, duke dhënë elementet që prijnë dhe ndihmojnë për të sjellë në jetë plane e projekte konkrete për kujdesin e shtëpisë së përbashkët.

Këto dy nisma të Selisë së Shenjtë na nxisin dhe na sfidojnë si françeskanë për t'u angazhuar në jetën tonë dhe në misionin tonë të kujdesit dhe të mbrojtjes. Gjithashtu, shohim me gëzim se, me fushatën **Revolucioni *Laudato Si'***, të nxitur nga zyrat DPIK të Urdhrit dhe të Familjes françeskane, në bashkim dhe sintoni të plotë me krejt Kishën. "*Si individë, vëllazëri, Entitete dhe si Urdhër ndërkombëtar, ndihemi fort të thirrur për të bërë një zgjedhje të qartë e rrënjësore të orientuar nga modalitetet e jetës të treguara nga *Laudato Si'**" (KPU/18 nr. 154).

LAJME TË TJERA



Emërime për Collegium Sancti Bonaventurae

Fra Bill Short (Provinca e Shën Barbarës, SHBA) është riemëruar Drejtor i Collegium Sancti Bonaventurae dhe fra Benedikt Mertens (Provinca e Shën Elizabetës, Gjermani) është emëruar zëvendës drejtor i parë. Collegium-i e ka selinë në Shën Izidor (Romë) dhe është i specializuar për të vënë dorëshkrime françeskane mesjetare në dispozicion të lexuesve të kohës dhe në botimin e Archivum Franciscanum Historicum, një revistë prestigjioze akademike. Për më shumë informacione mbi punën e tyre: www.quaracchi.org.

Filipine: Papa ka ngritur një kishë të hershme françeskane në Bazilikë Minore

Shenjtërorja e San Pedro Bautista, kisha më e hershme e Quezon City dhe e administruar nga françeskanët, është deklaruar Bazilikë minore nga papa Françesku, një nder i rrallë për një famulli katolike në Filipine. Në nivel kombëtar, ka vetëm 17 kisha që e mbajnë këtë përcaktim.

Shenjtërorja, që i përket vitit 1590, është një prej kishave më të hershme të vendit.

Kisha është e vendosur në të njëjtën zonë të gjetur nga shenjti pajtor i famullisë, Shën Pedro Bautista, kur u caktua në Filipine.

Shën Pedro Bautista, misionar françeskan dhe teolog i njohur, shërbeu në këtë vend për 10 vjet para se të dërgohej në Japoni ku u martirizua. Burimi: cbcnews.net



Shqipëri: Famullia françeskane e dekoruar për punë humanitare

Më 7 qershor 2020 famullia françeskane e Shën Mhillit në Laç, Shqipëri, është dekoruar prej Presidentit të Republikës, Z. Ilir Meta, me “Medaljen Nënë Tereza” për angazhimin e treguar pas tërmetit dhe gjatë pandemisë së Covid-19: “Në vlerësim dhe me mirënjohje të lartë për kontributin e jashtëzakonshëm humanitar, material dhe shpirtëror të dhënë në ndihmë të familjeve të dëmtuara nga tërmeti i 26 nëntorit 2019, si shembull i solidaritetit dhe mirësisë njerëzore dhe fetare”.

Presidenti ia ka dorëzuar dekoratën famullitarit, fra Ndue Toplana së bashku me fra Sokol Pepushaj. Në fjalimin e tij ka falënderuar frerët, motrat, vullnetarët dhe dhuruesit për shërbimin e tyre në këtë kohë, jo vetëm për ndihmën materiale që kanë dhënë, por sidomos për atë shpirtërore që ua japin gjithmonë besimtarëve.

SHBA: Revista françeskane të dekoruara për ekselencën

Më 7 korrik 2020, Franciscan Media (Provinca e Shën Gjon Pagëzuesit, SHBA) ka shpallur se St. Anthony Messenger është njohur si Revista e vitit me Catholic Press Association Awards të vitit 2020. Dhe Holy Land Review, që mbështet misionin e françeskanëve të Tokës së Shenjtë, është votuar si Revista e vitit (Misione).

Catholic Press Association e Shteteve të Bashkuara dhe Kanadasë, është një shoqatë gazetarësh dhe specialistësh të mediave, me më shumë se 600 organizata anëtare. Lista e plotë e dekoratave të këtij viti është e disponueshme në: Catholicpress.org.



Poloni: Kurs formimi i frerëve të Konferencës Veri-Sllavike

Nga data 28 qershor deri më 11 korrik është zhvilluar në Dursztyn, në Poloni, kursi i formimit i frerëve që janë duke u përgatitur për të bërë kushtet e përjetshme në Urdhër.

Në takim kanë marrë pjesë 14 frerë të ardhur nga katër provinca të Polonisë dhe të Ukrainës, të shoqëruar nga formuesit e tyre përkatës.

Pikë qendrore e kursit ka qenë eukaristia dhe lutjet e përditshme. Vëllezërit kanë mundur të thellojnë njohuritë e tyre duke marrë pjesë në mësimet në lidhje me tematika të ndryshme sikurse komunikimi ndërpersonal, pjekuria njerëzore, kushtet rregulltare (në aspekte të ndryshme), formimi i përhershëm, misionet, shërbimi në Tokën e Shenjtë dhe baritorja familjare.


Përditësim: Kapitulli gjeneral

Definitori gjeneral, pasi ka marrë në shqyrtim përgjigjet që kanë ardhur nga Presidentët e Konferencës, ka vendosur që kremtimi do të bëhet në Romë, në formë të reduktuar dhe, në pajtim me zhvillimin e pandemisë, në afërsi të Solemnitetit të Rrëshajëve ose, më së largu, në muajt shtator/tetor 2021.

Delegati i ri gjeneral pro monialibus

Me miratimin e Kongregatës për Institutet e Jetës së Kushtuar dhe Shoqëritë e Jetës Apostolike, fra Ignacio CEJA JIMÉNEZ, Definitor gjeneral, është zgjedhur “Delegat gjeneral pro monialibus”, duke zëvendësuar fra Fernando MENDOZA LAGUNA, që kthehet nën dëgjuesen e Ministrisë së tij, në Provincën e Shën Pjetrit e Palit, në Meksikë.

SHËNUES LIBRI FRANÇESKAN



ENZO FORTUNATO, PIERO DAMOSSO, *Francesco e il sultano. 800 anni da un incredibile incontro (Frangësku dhe sulltani, 800 vjet pas një takimi të pabesueshëm)*, Botimet San Paolo, Cinisello Balsamo 2019, fq. 180.

800 VJET MË PARË — ndërsa po zhvillohej Kryqëzata e pestë që do t'i çonte kryqtarët në territore të reja larg Jerusalemit dhe do t'i bënte të ndesheshin me sulltanin e Ayyubidëve në deltën e Nilit, pranë qytetit të Damietës — shën Frangësku i Asizit ndërmoi një udhëtim revolucionar aq sa edhe të rrezikshëm dhe me rezultat të pasigurt, në drejtim të Egjiptit, për të takuar sulltanin al-Kamil. Qe lutja për ta mbështetur dhe vullneti i njëmendtë për paqe. Një ngjarje ende edhe sot plot me domethënie dhe bartëse e një mesazhi gjithmonë aktual e të fortë.

Takimi efektivisht u bë, përmbajtjen e dialogut nuk e dimë, por ajo që na mjafton të dimë është se ai ballafaqim u bë dhe që i frytshëm, duke treguar pasurinë që mund të lindë prej takimit të kulturave të ndryshme kur ekziston vullneti për t'u hapur dhe për t'u kuptuar. Këtu, Enzo Fortunato ripërshkon etapat e ecjes së Frangëskut dhe të frangëskanëve, duke u nisur nga ai udhëtim i pashmangshëm kur Ungjilli takoi Kuranin. Piero Damosso na paraqet – nëpërmjet etapave të vona të dialogut të krishterë të mbështetura nga papa Frangësku, Benedikti XVI dhe shën Gjon Pali II, për të arritur në deklaratën përcaktuese dhe të frytshme të Abu Dabit mbi “vëllazërinë njerëzore” të vitit 2019 — nevojën për të rifituar, edhe pikërisht prej shembullit frangëskan, dashurinë ndaj vëllezërve, respektin për kulturat e tjera në njohjen e lirisë së tjetrit dhe të së drejtës së barabartë për jetë, të dëshiruara pikërisht prej vetë Hyjtit.


A cura di Elisabetta Lo Iacono
**FRATE FRANCESCO
E LA SPOGLIAZIONE**
Ieri e oggi



ELISABETTA LO IACONO, *Frate Francesco e la spogliazione. Ieri e oggi (Frat Frangësku dhe zhveshja. Dje dhe sot)*, Botime frangëskane italiane, Perugia 2019, fq. 192.


Cila është domethënia e zhveshjes në kohën që jemi duke jetuar? Duke nisur prej vetëzhveshjes së Jezu Krishtit, nga

ku ka zanafillën gjithçka, ripërshkohet dhe analizohet zhveshja e Frangëskut të Asizit, nëpërmjet një shumësie leximesh që kapërcejnë fushën historike e hagiografike për të na arritur, me një aktualitet të papritur, në kërkimin tonë të përditshëm të kuptimit dhe të përforcimit në fe.



WILLIAM R. HUGO OFMCAP, JOANNE SCHATZLEIN OSF, *Studying the Life of Saint Clare of Assisi: A Beginner's Workbook (Të studiosh Jetën e Shenjtes Kjara të Asizit: një Kartelë Pune për fillestarë)*, New City Press, Hyde Park 2019, fq. 318.

Ky burim unik në gjininë e vet i ndihmon lexuesit të zbulojnë Shenjten Kjara nëpërmjet një serie kapitujsh të thjeshtë që fillimisht informojnë në lidhje me burimet e jetës dhe të shkrimeve të Shenjtes Kjara dhe pastaj e aplikojnë këtë njohuri në argumente të jetës së saj të lehtë për t'u trajtuar. Kjo kartelë pune ka pasur sukses me të diplomuar dhe persona që përgatiteshin për marrjen e doktoraturës. Funksionon për këdo që dëshiron të bëjë një studim të udhëhequr mbi jetën e Shenjtes Kjara të Asizit duke përdorur burimet kryesore. Mes përfituesve të kësaj metode unike janë frangëskanët e çdo lloj mjedisi, veçanërisht ata që marrin pjesë në programe formimi, studentë të përshtetërisë femërore apo mesjetare, historianë të jetës rregulltare, gra e burra që kryejnë shërbim për frangëskanët, shtegtarë që kanë vizituar Asizin dhe kushdo që dëshiron të mësojë se si persona të ndryshëm në historinë e Kishës u janë përgjigjur rrethanave të saj të ndryshueshme. Të studiosh jetën e Shenjtes Kjara i ndihmon lexuesit të kuptojnë intuitën frangëskane sipas modaliteteve që shkojnë përtej shën Frangëskut të Asizit.



MURRAY BODO OFM, *Insegnare all'anima a parlare (T'i mësosh shpirtit që të flasë)*, Tau Publishing, Phoenix 2020.

Nëpërmjet pesë seksioneve të librit, Bodo bashkon shtatëdhjetë e tre këngë bukur të sintonizuara trup e shpirt në një shkëmbim muzikor me intensitet lirik ndërsa eksploron kompleksitetin e ekzistencës së vet, si djalë që dëshiron t'i bëjë qejfin të atit gjatë një gjuetie, deri te shkatërrimi i planetit tonë për shkak të ngrohjes globale. Poezitë e Bodos janë të sakta, origjinale, nganjëherë reflektive dhe të domosdoshme.

Murgu trapist Thomas Merton ka shkruar: “Një poezi e mirë të bën të bësh një përvojë që nuk do të mund të prodhohej nga asnjë kombinim tjetër fjalësh”. Ky koleksion është për antonomazi një përvojë në këta terma për lexuesin bashkëkohor.

NGJARJE



NDJESA E ASIZIT 2020

Porciunkola është një "derë gjithmonë e hapur" për të gjithë ata – shtegtarë dhe vendas – që duan të marrin hirin e Hyjit nëpërmjet përvojës së Pajtitimit.

Më 1 gusht 2020 do të jetë dita e hapjes të së Kremtes së Ndjesës. Si zakonisht, fra Michael Perry, Ministër gjeneral, do të drejtojë Kremtimin Solemn Eukaristik që do të përfundojë me Procesionin e "Hapjes së Ndjesës": e quajtur kështu sepse prej atij momenti, pra prej orës 12 të 1 gushtit, deri në orën 24 të 2 gushtit Ndjesa e plotë e dhënë në Porciunkola përditë shtrihet në të gjitha kishat famullitare të përhapura në botë si dhe në të gjitha kishat françeskanë.

Do të jetë e mundur të ndiqen të gjitha ngjarjet drejtpërdrejt nëpërmjet WebTV të Porciunkolës, nga aplikacioni falas "Fрати Assisi" dhe nga Kanalet sociale "Fрати Assisi" Facebook dhe YouTube. Për më shumë informacione: www.assisi ofm.it

KURSE TË SHKOLLËS SË MESME TË STUDIMEVE MESJETARE E FRANÇESKANE A.A. 2020-2021

Shkolla e Mesme e Studimeve Mesjetare e Françeskane do të mundësojë vitin e ardhshëm akademik:

- Diplomën e Specializimit në Studime Mesjetare
- Masterin Universitar të Nivelit të Dytë në Mesjetën Françeskane

Leksionet do të mbahen në prani dhe online, nga e hëna deri të mërkurën (15:15-18:35).

REGJISTRIMET: Nga 14 shtatori deri më 16 tetor 2020. Është i mundur regjistrimi në kurse të veçanta.

Përshkrimi i hollësishëm i kurseve mund të konsultohet online në Vjetarin Akademik 2020-2021 të Universitetit Papnor Antonianum në adresën web:

<http://www.antonianum.eu/it/orientamento/download>



SCUOLA SUPERIORE
DI STUDI MEDIEVALI
E FRANCESCANI

VIZITATORI GJENERAL

për Provincën e Kryqit të Shenjtë,
në Brazil (Belo Horizonte)

FRA REGINALDO RÔMULO
MONTE CANTO

i Kustodies së Shën Benediktit
të Amazonas, në Brazil

KURSE ONLINE MBI EKOLOGJINË INTEGRALE

Zyra DPIK OFM ofron një seri kursesh online mbi enciklikën Laudato Si' dhe mbi ekologjinë integrale si pjesë e Revolucionit Laudato Si'. Kurset ofrohen në katër gjuhë dhe janë të hapura për publikun në mënyrë që të ndihmojnë të gjithë për të thelluar perspektivat e tyre mbi krizat aktuale ekologjike dhe mbi misionin për të krishterët, në veçanti françeskanët.

Çdo kurs zgjat dhjetë javë dhe përbëhet nga video-leksione, material për lexim dhe provime. Kursi i anglishtes do të fillojë më 7 shtator 2020. Fra Jacek Orzechowski OFM ka organizuar programin, në të cilin marrin pjesë teologë, mësues dhe aktivistë. Pjesëmarrësit në kurs do të mësojnë ekologjinë integrale dhe aktualizimin e saj në termat e perspektivave françeskane, pikëpamje hebraike e myslimane, stile të jetës ekologjike dhe aktivizëm mjedisor nga bashkëbisedues të ndryshëm. Për më shumë informacione: www.laudatosirevolution.org.

